



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE

Datë: 29.07.2026

Kryetari i Komunës, pas shqyrtimit të propozimit Nr. 1362, të datës 29.07.2026, paraqitur nga Drejtori i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport – Ylber Kelmendi, bazuar në nenin 58, shkronja (b), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr.03/L-040 (GZ Nr.28/2008), nenin 43, shkronja (b), të Statutit të Komunës, Nr.98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Lejohet rivendosja e afatit dhe lejimi i aplikimeve plotësuese për thirrjen publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekt-propozimeve, programeve të OJQ-ve dhe nismave të individëve, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh kalendarike nga dita e publikimit, si në propozimin me Nr. 1362, të datës 29.07.2026.
2. Zbatimi i këtij vendimi është në kompetencë të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
3. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e nënshkrimit, nga Kryetari i Komunës.

Akti i dorëzohet:

- 1x Kryetarit të Komunës
- 1x Drejtorisë së KRS
- 1x Arkivit

